



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT

– Njoftim për media –

Shkup, 11.06.2026

### Pagesa të pajustificuara për shkak të mangësive në sistemin e realizimit dhe pagesës së të drejtave nga mbrojtja sociale

*Dobësitë në kontrollet sistemore dhe në shkëmbimin e të dhënave ndërmjet institucioneve, dhe përditësimi dhe verifikimi i pamjaftueshëm i të dhënave për përfituesit, kanë kontribuar në kryerjen e pagesave të të drejtave sociale pa përmbushjen e plotë të kushteve të përcaktuara me ligj dhe d;min e shkaktuar n; Buxhetin e shtetit.*



**Enti Shtetëror i Revizionit**, në përputhje me Programin Vjetor të Punës për vitin 2025, ka kryer auditim të pajtueshmërisë me temën: **“Pagesa e të drejtave për ndihmë financiare nga mbrojtja sociale”**.

Auditimi ka përfshirë periudhën nga **viti 2022 deri në fund të muajit qershor 2025**, ndërsa disa çështje, ngjarje dhe analiza janë shqyrtuar edhe për periudhën pasuese deri në ditën e raportimit të auditimit. Qëllimi ishte të vlerësohej mënyra se si realizohen aktivitetet që lidhen me ushtrimin e të drejtave për ndihmë financiare nga mbrojtja sociale në Republika e Maqedonisë së Veriut, si dhe pagesa e tyre, e cila realizohet përmes Ministria e Punës dhe Politikës Sociale gjegjësisht Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë (MPSDR).

**Nga revizioni i kryer, revizorët kanë konstatuar se sistemi dhe aktivitetet për realizimin, pagesën dhe kontrollin e të drejtave nga mbrojtja sociale nuk janë në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me legjislacionin përkatës ligjor dhe nënligjor.**

Procedura për realizimin e të drejtave nga mbrojtja sociale zbatohet përmes **Institucioneve Publike – Qendrave për Punë Sociale (QPS)**, të cilat vendosin dhe marrin vendime për pagesën e këtyre të drejtave.

Lëndë e revizionit kanë qenë të drejtat për ndihmë financiare nga mbrojtja sociale që janë të rëndësishme për këtë temë, konkretisht:

- ndihma minimale e garantuar;
- kompensimi për shkak të aftësisë së kufizuar;
- kompensimi për ndihmë dhe kujdes nga një person tjetër;
- kompensimi i pagës për orar të shkurtuar pune;
- shtesa për strehim;
- kompensimi i përhershëm;
- ndihma financiare e njëhershme;
- siguria sociale për personat e moshuar;
- e drejta për invaliditet civil dhe
- e drejta për mbrojtje sociale për personat që kërkojnë azil.

Analiza e **kornizës ligjor** në fushën e mbrojtjes sociale tregon se ekzistojnë paqartësi dhe mospërputhje të shumta ndërmjet akteve nënligjore të miratuara dhe kërkesave për realizimin e të drejtave, veçanërisht në pjesën që ka të bëjë me dokumentacionin që duhet të sigurohet zyrtarisht nga institucionet kompetente. Këto mangësi krijojnë mospërputhje administrative dhe mundësi për zbatim të ndryshëm në praktikë.

**Programi Kombëtar për Zhvillimin e Mbrojtjes Sociale 2022–2032** përcakton një kornizë afatmesme dhe afatgjatë të aktiviteteve dhe masave të planifikuara në fushën e mbrojtjes sociale. Megjithatë, zbatimi i tij ka qenë i kufizuar dhe nuk është krijuar mekanizmi i paraparë koordinues për monitorimin dhe vlerësimin e programit. Programet vjetore dhe planet strategjike të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe Demografisë kanë kryesisht karakter buxhetor, pa një bazë sistematike analitike, pa tregues të matshëm dhe pa vlerësim të efekteve, gjë që kufizon rolin e tyre në menaxhimin e reformave.

Nga të gjitha të drejtat e paguara në fushën e mbrojtjes sociale në formë kompensimesh financiare, duke përfshirë edhe pagesat për mbrojtje shëndetësore, gjatë vitit 2024 janë paguar mjete në vlerë totale prej **10.003.289 mijë denarë gjegjësisht 162.128.000 euro**, që përbëjnë **15% të shpenzimeve totale** të MPSDR. Këto mjete janë paguar për **një numër mesatar prej 113.666 përfituesish të të drejtave sociale**. Pagesat në periudhën **2022–2024 shënojnë një trend rritës prej rreth 30%**, që tregon një rritje të vazhdueshme të mjeteve të ndara nga buxheti për këtë qëllim.

Në procedurat për realizimin e të drejtave janë konstatuar dobësi që lidhen me dokumentacion të paplotë dhe mosrespektim të kriterëve ligjore. Një pjesë e të

drejtave janë realizuar pa përmbushjen e plotë të kushteve dhe pa dokumentacionin e detyrueshëm, ndërsa janë evidentuar mangësi në zbatimin e procedurave, si vijojnë:

- moskryerja e vizitës dhe verifikimit të drejtpërdrejtë në familje;
- rishikimi vjetor i pamjaftueshëm ose i pazbatuar i të drejtave;
- vonesa në marrjen e vendimeve dhe evidencë zyrtare e paplotë.

**Këto gjendje ndikojnë në përcaktimin jo të saktë të gjendjes faktike, zvogëlojnë sigurinë juridike, krijojnë trajtim të pabarabartë të qytetarëve, rrisin rrezikun e shpenzimit të pajustificuar të fondeve publike dhe ulin efikasitetin e sistemit të mbrojtjes sociale.**

Në procedurën për realizimin e të drejtave nga mbrojtja sociale, **Qendrat për Punë Sociale (QPS)** sigurojnë pjesën më të madhe të dokumentacionit sipas detyrës zyrtare përmes një sistemi të integruar informativ të quajtur **SPIL**, si dhe përmes shkëmbimit të të dhënave me institucione të tjera. Edhe pse janë nënshkruar memorandume bashkëpunimi për lehtësimin e procedurave, sigurimi i këtyre të dhënave vazhdon të paraqesë sfidë. Dobësitë e konstatuara në shkëmbimin e informacionit ndikojnë në realizimin e drejtë dhe në kohë të të drejtave sociale.

Për shkak të mangësive në kontrollet sistemore dhe në shkëmbimin apo marrjen e të dhënave sipas detyrës zyrtare, revizorët kanë konstatuar se **gjatë vitit 2024** gjithsej **235** përfitues kanë fituar ose përdorur njëkohësisht si të drejta nga mbrojtja sociale ashtu edhe pension, gjë që ka rezultuar në pagesa të pajustificuara në vlerë prej **14.536** mijë denarë gjegjësisht rreth **236** mijë euro prej të cilëve:

- **10.763** mijë denarë janë paguar për **190** përfitues në bazë të ndihmës minimale të garantuar;
- **426** mijë denarë për **5** përfitues në bazë të kompensimit të përhershëm ;
- **3.347** mijë denarë për **40** përfitues në bazë të të drejtës për siguri sociale të personave të moshuar .

Lidhur me të drejtën për siguri sociale të të moshuarve , është konstatuar se **11** përfitues e kanë realizuar këtë të drejtë pa e përmbushur kushtin e kufirit të moshës, për çka janë paguar në mënyrë të pajustificuar **3.211** mijë denarë ose **52** mijë euro.

Për më tepër, te **12** përfitues në sistemin e integruar informativ nuk janë paraqitur të dhëna se personi i papunë merr kompensim financiar për papunësi. Si pasojë, nuk janë marrë vendime për ndërprerjen ose zvogëlimin e shumës së ndihmës minimale të garantuar, duke rezultuar në pagesa të pajustificuara në vlerë prej **740** mijë denarë ose **12** mijë euro.

Për më tepër, revizorët kanë konstatuar se Qendrat për Punë Sociale (QPS) dhe Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut (APRMV) nuk e zbatojnë në mënyrë efikase detyrimin ligjor për hartimin dhe monitorimin e planeve individuale të aktivizimit për përfituesit e papunë të Ndihmës Minimale të Garantuar (NMG). Planet hartohen në një masë shumë të kufizuar, kryesisht në mënyrë manuale dhe

jo elektronike, pa bashkëpunim funksional, pa koordinatorë të caktuar dhe pa takime të rregullta ndërmjet institucioneve. Për shkak të burimeve të kufizuara njerëzore dhe koordinimit të pamjaftueshëm, nuk ndërmerren aktivitete të mjaftueshme për aktivizimin në punë dhe integrimin e përfituesve të NMG-së në tregun e punës. Kjo kontribuon në varësinë afatgjatë nga ndihma sociale dhe ul efektivitetin e sistemit të mbrojtjes sociale.

**Revizorët kanë evidentuar gjithashtu dobësi dhe veprime jo të njëjta në procesin e kthimit të mjeteve të paguara pa bazë ligjore nga mbrojtja sociale. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Demografisë nuk ka miratuar udhëzime dhe procedura të qarta për lidhjen dhe monitorimin e marrëveshjeve për kthimin e mjeteve, për shkak të së cilës QPS-të përcaktojnë në mënyra të ndryshme afatet, numrin dhe lartësinë e kësteve të pagesës. Pjesa më e madhe e QPS-ve nuk kanë krijuar evidencë të rregullt për kërkesat financiare dhe arkëtimin e tyre.**

Gjithashtu, nuk ekziston një sistem i organizuar për monitorimin e pagesave dhe mjeteve të kthyer, as koordinim i mjaftueshëm ndërmjet Ministrisë dhe QPS-ve, gjë që krijon rrezik për arkëtim të vonuar ose jo të plotë të detyrimeve. Megjithëse inician procedura gjyqësore për arkëtimin e borxheve, në praktikë këto kërkesa vështirë realizohen, pasi të ardhurat nga mbrojtja sociale janë të përjashtuara nga përmbaruesit. Si rezultat, përfituesit, pas një periudhe të caktuar kohe, mund të fitojnë sërish të drejtën për ndihmë sociale, ndërkohë që borxhet e mëparshme mbeten të paarkëtuara.

Spektori për Mbrojtje Sociale pranë MPSDR nuk kryen analiza të të dhënave të marra nga Qendrat për Punë Sociale (QPS) dhe nuk e realizon plotësisht rolin e tij në hartimin dhe monitorimin e politikave sociale, që ndikon negativisht në cilësinë dhe efikasitetin e sistemit të mbrojtjes sociale.

**Njëkohësisht, revizorët kanë konstatuar kushte të papërshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e dokumentacionit në shërbimet për ndihmë financiare të Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale – Shkup . Pjesa më e madhe e këtyre shërbimeve janë të vendosura në baraka me kushte të dobëta pune dhe me hapësira të papërshtatshme për pritjen e qytetarëve. Dokumentacioni ruhet në korridore dhe zyra, në kuti kartoni dhe regjistratore, pa masa të mjaftueshme mbrojtëse. Kjo gjendje nuk është në përputhje me Ligjin për veprimtarinë arkivore dhe krijon rrezik për dëmtimin, humbjen ose shkatërrimin e dokumentacionit, si dhe kushte të papërshtatshme për punë dhe për pranimin e qytetarëve.**

## Kushtet për punën dhe ruajtjen e dokumentacionit në QPS



Mbikëqyrja inspektuese pranë MPSDR nuk kryhet mbi bazën e një evidence të plotë të vlerësimit të rrezikut, nuk përfshin të gjitha të drejtat sociale në mbikëqyrjet e rregullta dhe zvogëlimi i inspektimeve të rregullta në favor të atyre të jashtëzakonshme krijon mundësi për uljen e efektivitetit të saj në zbulimin dhe parandalimin e parregullsive.

Në pjesën **Theksim i Çështjeve**, revizorët raportojnë për shpërndarje të pabarabartë të lëndëve dhe ngarkesë jo të barabartë të burimeve njerëzore ndërmjet Qendrave për Punë Sociale (QPS) si dhe për procedura të iniciuara para organeve kompetente për shkak të parregullsive ligjore dhe dyshimeve për pagesa të pajustificuara gjatë realizimit të së drejtës për siguri sociale për personat e moshuar.

Në pjesën **Çështje të tjera**, revizorët raportojnë se Ligji për Mbrojtjen Sociale nuk është mjaftueshëm i qartë në pjesën që rregullon kryerjen e verifikimit të drejtpërdrejtë në familje. Kjo mund të çojë në zbatim jo të njëjtë të ligjit dhe në zvarritje të procedurave administrative, ndërsa përsëri Ligji për Sigurinë Sociale të Personave të Moshuar nuk përmban dispozita të qarta për kthimin e mjeteve të përfituara pa bazë ligjore, duke krijuar paqartësi juridike dhe rrezik për përdorim të parregullt të mjeteve buxhetore. Njoftuam edhe për mbivendosje të bazës së përfituesve ndërmjet kompensimeve për aftësi të kufizuar, ndihmës dhe kujdesit nga një person tjetër, si dhe shërbimeve të kujdesit në shtëpi; mungesë të shkëmbimit sistematik ose marrjes automatike të të dhënave sipas detyrës zyrtare për personat që punojnë pa marrëdhënie të rregullt pune; mungesë të të dhënave të integruara për personat që qëndrojnë ose punojnë jashtë vendit.

Për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara, revizorët kanë dhënë rekomandime për avancimin e kornizës ligjore, planifikimit programor, procedurave për realizimin e të drejtave për ndihmë financiare dhe mbikëqyrje mbi pagesat e këtyre, me qëllim të përdorimit më efikas dhe më efektiv të mjeteve buxhetore dhe të zvogëlohet ngarkesa mbi sistemin e mbrojtjes sociale.

**Press kontakt:**

**Albiona Mustafa Muhaxhiri** +389 72228 203 [albiona.mustafa@dzt.gov.mk](mailto:albiona.mustafa@dzt.gov.mk)

**Martin Duvnjak** +389 75 268 517 [martin.duvnjak@dzt.gov.mk](mailto:martin.duvnjak@dzt.gov.mk)